VENDIM
Nr.136, datë 23.2.2011

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.138, DATË 23.3.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET TEKNIKE TË VLERËSIMIT DHE PËRLLOGARITJES SË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË PASURIVE, QË SHPRONËSOHEN, TË PASURIVE QË ZHVLERËSOHEN, DHE TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË TRETË, PËR INTERES PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 6 të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

"7. Ministri përgjegjës për investimet publike në akset rrugore kombëtare ka të drejtë të aplikojë procedurë përjashtimore me çmimin që caktohet sipas kësaj pike, për vlerësimin e sipërfaqeve që shpronësohen, pavarësisht nga kategoria e tyre në të gjitha rastet kur konstaton se çmimi i vlerës sipas pikës 1 të këtij vendimi, është më i vogël se 100% e mesatares së shitblerjes që ka zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose më i lartë se 100% e saj.

Në të gjitha rastet e kryerjes së shpronësimit për akset rrugore kombëtare, struktura përgjegjëse, që merret me procedurën e shpronësimit, është e detyruar të verifikojë me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas procedurës dhe kritereve të pikës 1 të këtij vendimi, çmimin e hartës së vlerës me mesataren e shitblerjeve. Procedura përjashtimore iniciohet nga ministri përgjegjës për investimet publike në akset rrugore kombëtare vetëm kur, për këtë procedurë, Ministri i Financave i ka dhënë miratimin paraprak me shkrim. Përgjigjja e Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Ministrit të Financave është pjesë përbërëse e dosjes së shpronësimit. Kur Ministri i Financave, në bazë të interesit publik, refuzon dhënien e miratimit, procedura e vlerësimit vijon në bazë të hartës së vlerës.".

2. Ky vendim nuk do të zbatohet në rastin e kërkesave për shpronësim, të cilat janë publikuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha